



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:145284

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06004633

KPPP.nr.328/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, me seli në Prishtinë, rruga “Armend Daci” nr.1, kundër debitorit “Ylberi” SH.P.K., me NRB: 600817235, me seli në Rahovec, fshati Krushë e Madhe, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit mbi lejimin e Përmbartimit CP.nr.320/14 të datës 05.05.2014, të Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, jashtë seancës me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Ylberi” SH.P.K., dhe Aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit CP.nr.320/14 i datës 05.05.2014, i lejuar nga Gjykata Themelore ë Gjakovë – Dega në Rahovec, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, ka lëshuar Aktvendimin për Caktimin e Përmbartimit CP.nr.320/14 të datës 05.05.2014, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të përmbartueshëm Aktvendimit Nr.124 të datës 23.01.2014, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori që në emër të gjobës administrative kreditorit t’ia paguaj shumën prej 5,000.00 €, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë me bllokimin e llogarive bankare, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e pasurive të debitorit deri në pagesën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se kreditori në aktvendimin i cili është objekt i kësaj procedure përmbartimore ka konstatuar se debitori ka qenë duke punuar në mënyrë ilegale me rërë dhe

zhavorr dhe se në vend ka gjetur makineri për kryerjen e këtij aktiviteti. Tutje ka shtuar se debitori e ka të regjistruar biznesin “Ylberi” SH.P.K., me numër të biznesit 900817235, pranë organeve kompetente, i njëjti ka qenë në përgatitjen e dokumenteve të nevojshme për marrjen e licencës tek kreditori, dhe se asnjëherë nuk ka zhvilluar aktivitet por vetëm i ka vendosur pajisjet në truallin e tij. I ka propozuar gjykatës që ekzekutimin e lejuar ta refuzoj.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, me aktvendimin CP.nr.320/14, të datës 24.02.2015, e ka refuzuar prapësimin e debitorit si të pabazuar, ndërsa ka lënë në fuqi Aktvendimin mbi lejimin e Përmbarimit CP.nr.320/14 të datës 05.05.2014.

Debitori me datë 19.06.2015, ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes të dispozitave të procedurës përmbarimore, si dhe konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa, ndërsa aktvendimi i shkallës së parë të anulohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me Aktvendimin Ac.nr.4488/2015 të datës 08.11.2016, ka aprovuar ankesën e debitorit, ka anuluar aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Sipas nenit 22 par.1 të LPP-së, janë përcaktuar dokumentet përmbaruese ndërsa me par.1 nën par. 1.2 të këtij neni, si dokument përmbarues përcaktohet: *“vendimi përmbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi (më tej: ujdia)”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së,

përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbardim, organit përmbardues i dorëzohet edhe dokumenti përmbardues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbardueshmërisë për përmbardueshmëri”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Vendimi i Komisionit për Miniera dhe Minerale me numër 124 i datës 23.01.2014, në bazë të së cilit është mbështetur propozimi për përmbardim është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbardim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbardim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbardim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbardimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*.

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi mbi lejimin e përmbardimit CP.nr.320/14 i datës 05.05.2014, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbardim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbardimor dhe rrjedhimisht propozimi për përmbardim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar përmbardimi.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbardim, ndërsa organi përmbardues – Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbardim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbardues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbardimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.328/24, datë 31.07.2024

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.